

Per Ju qe Deshironi te Ndhmoni!

Tel.: + 49 (20 1) 75 99 85 28
Fax: + 49 (20 1) 75 99 85 29
E-Mail: info@i-de-al.org
Web: www.i-de-al.org

Amtsgericht: Essen VR 5251



IDEAL e.V. | Rellinghauser Str. 22 | 45128 Essen

Integrative Deutsch-Albanische Gesellschaft
Steuernr.: 112/5870/1294

„Wir helfen Albanien“

Bankverbindung: Volksbank
IBAN:
DE 19 301602130038378015

Te dashur bashkatdhetare, liebe Freunde Albaniens,

Präsidentin: Anduena Stephan
Stellv. Präsident: Alban Shehu

termeti i dates 26 Nentor dhe lekundjet e tjera te mepasshme kane shkaktuar humbjen e jetes per me shume se 40 persona, me dhjetra godina jane shkaterruar e me qindra jane bere te pabanueshme!

IDEAL me vendim unanim ka vendosur te krijojte nje konto te vecante per te mbledhur ndihma financiare dhe materiale per te ndihmuar sa me shume familje ne nevoje, femije, te rinj e te moshuar.

Ndihma duhet per sot, por jo vetem!

Kopshtet, shkollat, institucionet publike kane nevoje per ndihme per nje kohe te gjate. Femijet e traumatizuar, shume prej te cileve kane mbetur pa strehe mbi krye kane nevoje per mbeshtetje gjithë vjetore!

Cdo dhurim e **kontribut financiar, material apo njerezor** (mjeke, mesues, prinder, profesioniste) eshte i mirepritur!

Donacionet Financiare:

Deshiron te dhurosh? Llogaria bankare e meposhtme eshte vetem per „**Wir Helfen Albanien**“:

Kontoinhaber: Integrative Deutsch-Albanische Gesellschaft e.V. (IDEAL)
Kontonr.: 38 37 80 23
Blz: 301 602 13
Bank: Volksbank Düsseldorf Neuss eG
IBAN: DE94 301602130038378023
Verwendungszweck: „Wir helfen Albanien“ – Name, Nachname, Anschrift

I gjithë donacioni do te destinohet per mbeshtetjen e femijeve te kopshteve, shkollave fillore apo tetevjecare te zones se Kurbinit dhe Thumanes. Cdo donacion financiar do te dokumentohet dhe konfirmohet me shkrim nga shoqata deri ne Mars te vitit 2020. Ai mund te zbritet nga taksat vjetore ne Gjermani.

Donacionet Materiale:

Pas verifikimit ne terren dhe pas nxjerrjes se nje liste me materialet me te nevojshme ne kete zone, do te filloje pergatitja e grumbullimit te tyre ne Essen dhe do te behet transporti per ne Shqiperi.

Donancione Njerezore:

Te gjithë ju:

- mjeke,
- mesues,
- prinder,
- biznesmene,
- profesioniste
- punonjes social **behuni engjejt mbroites te nje familje ne nevoje!**

Ju mund te kontriboni duke dedikuar kohen tuaj per te mbeshtetur njerezit e femijet e traumatizuar me keshillat tuaja online apo me kontribut konkret ne terren gjate vizitave tuaja private ne Shqiperi.

IDEAL do te pergatise nje liste te ketyre nevojave dhe nese ju vini ne dispozicion kontaktet tuaja, keto do t'ua kalojme familjeve ne nevoje per komunikim direkt.

Manaxhimi i fondeve:

IDEAL do te beje derdhjen e fondeve te grumbulluara:

- ne nje llogari bankare te dedikuar te institucionit arsimor ne Kurbin a Thumane ose
- ne llogarine bankare te nje supermarketi, e lidhur kjo me listen e materialeve qe:
- do te porositen,
- do te paketohen per cdo nxenes apo familje nxenesi dhe
- do t'i dorezohen kryefamiljareve direkt ne prezence te Kryetarit te Komunes, Bashkise apo Kryeplakut dhe Drejtoreve te shkollave.

Bashkepunimi institucional:

IDEAL do te koordinoje te gjitha dorezimin e fondeve dhe materialeve permes:

- Konsullates se Nderit te NRW ne Gjermani,
- Ministrise se Jashtme te Shqiperise,
- Bashkive dhe Komunave si dhe
- Drejtorive te shkollave dhe kopshteve publike.

Mirenjohja per Donatoret:

IDEAL do te pergatise listen emerore te te gjitha donatoreve te rankuar ne menyre alfabetike dhe do ta publikoje ate ne faqen e saj te internetit si dhe ne mediat sociale dhe do ta lexoje dhe protokolloje zyrtarisht ne momentin e dorezimit te donacioneve ne Shqiperi.

Te gjitha se bashku te ndihmojme jo vetem sot, por dhe ne ditet, javet dhe muajt ne vazhdim!

Me mirenjohje!

IDEAL – Integrative Deutsch-Albanische Gesellschaft e.V.

Anduena Stephan

Alban Shehu